

VENDIM
Nr.848, datë 17.12.2004

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONE PRIVATE, QË PREKEN NGA REHABILITIMI I SHKARJEVE
NË HOTOLISHT, KM 89, NË SEGMENTIN RRUGOR LIBRAZHD – QUKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi i shkarjeve në Hotolisht, km 89, në segmentin rrugor Librazhd-Qukës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 392 tokë arë, me çmim 320 lekë/m², kulturë bujqësore, me sipërfaqe 500 m², me çmim 7 lekë/m², me vlerë të përgjithshme 128 940 (njëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 108 500 (njëqind e tetë mijë e pesëqind) lekë.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 237 440 (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Shpronësime” miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.12.2004.
 7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E TELEKOMUNIKACIONIT
QARKU ELBASAN
Rrethi Librazhd
Komuna Hotolisht

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SHKARJES NË KM 89
(HOTOLISHT) NË SEGMENTIN RRUGOR LIBRAZHD-QUKËS**

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore

Nr.	Pronari			Fshati Z.K.	Nr.i pasurisë	Tokë bujq. sip.m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë	Kulturë bujqësore sip.m ²	Çmimi lekë/copë	Vlera në lekë	Totali lekë
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Lutfi	Shaban	Quku	3843	896	392	320	125440	500	7	3500	128940
		Shuma				392		125440	500		3500	128940

Shpenzime procedurale: 108 500 lekë.

Vlera totale e shpronësimit: 237 440 lekë.